REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT / TELO ZA RAZMATRANJE
Nr/Br. 972/20
Datë/Datum. 10.12.20
PRISHTINË - PRIŠTINA

Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo

ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY

PSH.nr.972/20

PANELI SHQYRTUES, i emëruar nga Kryetari i OSHP-së, në bazë të nenit 105 dhe nenit 106 të Ligjit për Prokurim Publik të Kosovës nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/L-068 dhe Ligjin 05/L-092, në përbërje të Goran Milenković – Kryetar, Nuhi Paçarizi - Referues, Blerim Dina - Anëtar, duke vendosur sipas ankesës së parashtruar nga grupi i operatorëve ekonomik "Finaling"Shpk & NNP "Construction" & "NTSH'Edi floor"-Prishtinë, kundër njoftimit për dhënie të kontratës, ku është rekomanduar për kontratë operatorin ekonomik: "Bavaria" Shpk- Ferizaj, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: "Renovimi i objektit të ish –IKSHP-së për shërbime specialistike për Spitalin e Përgjithshëm Ferizaj" me nr.prokurimi 220-20-6824-5-2-1, iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) –"Spitali Ferizaj", më datën: 09.12.2020, mori këtë:

VENDIM

I. APROVOHET, pjesërisht si e bazuar ankesa e grupit të operatorëve ekonomik: "Finaling" Shpk & NNP "Construction" & "NTSH Edi floor"-Prishtinë, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull "Renovimi i objektit të ish –IKSHP-së për shërbime specialistike për Spitalin e Përgjithshëm Ferizaj" me nr. prokurimi 220-20-6824-5-2-1, iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) –"Spitali Ferizaj".

II. ANULOHET, njoftimi për dhënie të kontratës lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: "Renovimi i objektit të ish –IKSHP-së për shërbime specialistike për Spitalin e Përgjithshëm Ferizaj" me nr.prokurimi 220-20-6824-5-2-1, iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) –"Spitali Ferizaj", dhe anulohet në tërësi ky aktivitet i prokurimit, ndërsa nëse edhe më tutje AK-ja ka interes për të vazhduar më këtë aktivitet të prokurimit, të njëjtin mund ta Ritenderoj konform dispozitave të LPP-së.

III. Autoriteti Kontraktues në afat prej 10 ditësh duhet ta informoj me shkrim Panelin Shqyrtues për të gjitha veprimet e ndërmarra lidhur me këtë aktivitet të prokurimit.

IV. Mos respektimi i këtij vendimi, detyron Panelin shqyrtues që konform dispozitave ligjore të nenit 131 të Ligjit për Prokurim Publik të Kosovës nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/L-068 dhe Ligjin 05/L-092, të ndërmarr masa ndaj Autoritetit Kontraktues.

V. Me qenë se ankesa e grupit të operatorëve ekonomik ankues "Finaling"Shpk & NNP "Construction" & "NTSH'Edi floor"-Prishtinë, aprovohet pjesërisht si e bazuar, i bëhet kthimi i tarifës së ankesës në shumën e deponuar me rastin e parashtrimit të ankesës.

VI. Obligohet operatori ekonomik ankues që konform nenit 31 pika 6 të rregullores së punës së OSHP-së, në afat prej gjashtëdhjetë (60) ditësh të bëjë kërkesë për kthim të sigurimit të ankesës, në të kundërtën ju bëhet konfiskimi i depozitës dhe këto mjete kalojnë në Buxhetin e Republikës së Kosovës.

ARSYETIM

Grupi i operatorëve ekonomik "Finaling"Shpk & NNP "Construction" & "NTSH'Edi floor"-Prishtinë, si palë e pa kënaqur ka deponuar ankesë në OSHP, me 19.11.2020 me nr. 972/20, kundër njoftimit për dhënie të kontratës lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: "Renovimi i objektit të ish –IKSHP-së për shërbime specialistike për Spitalin e Përgjithshëm Ferizaj" me nr.prokurimi 220-20-6824-5-2-1, iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) –"Spitali Ferizaj", duke pretenduar se:

- Autoriteti kontraktues ka vepruar në kundërshtim me nenin: 1, 6, 7, 10, 59, 60, 64, 69, dhe 72 të Ligjit për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës.

Organi Shqyrtues i Prokurimit, konform nenit 113 dhe 114 të LPP-së me datë: 20.11.2020, ka autorizuar ekspertin profesional të prokurimit për të shqyrtuar vlefshmërinë e të gjitha pretendimeve të palës ankimore.

Eksperti profesional i prokurimit në raportin e dt: 30.11.2020, lidhur me pretendimin ankimore të OE ankues sqaron si në vijim:

Përgjigje në Pretendimin 1

Lidhur me pretendimin e grupit të OE Finaling"Shpk & NNP "Construction" & "NTSH'Edi floor"-,se AK gjatë vlerësimit, ekzaminimit dhe krahasimit të tenderëve ka eliminuar ofertën e tyre me arsyetimin se tek paramasa për tri pozicione (A 9, A 10, A 11) nuk ka ofruar çmime, eksperti shqyrtues ka këtë mendim.

Eksperti shqyrtues sqaron se AK në Letrën Standarde të datës 05.11.2020 ka përdorur Letrën Standarde për tenderuesin e pasuksesshëm duke nënvizuar që "Me keqardhje ju njoftojmë se tenderi i paraqitur nga ana juaj është i **Pa suksesshëm** për arsye se te paramasa ju kane munguar tri pozicione (A 9, A 10, A 11) nuk ka çmim" duke përdorur në mënyrë të gabueshme letrën standarde, sepse nëse do ishte i pasuksesshëm OE

ankues atëherë duhej të rekomandohej për kontratë ngase ka ofruar çmim më të lirë. Gjithsesi eksperti shqyrtues konsideron që ky mund të jetë një gabim teknik i paqëllimshëm nga ana e AK-së.

AK tek tabela e paramasës dhe çmimit ka vendosur 8 pozicione (të ndara në nën pozicione) ku janë përcaktuar edhe sasitë për çdo nën pozicion, ndërsa për pozicionet 9,10,11 dhe 12 AK ka dhënë një përshkrim të punëve që do të kryhen duke mos përcaktuar sasitë që nënkupton që OE për këto pozicione duhet të ofrojnë çmime paushallë Ne pozicionin 12 AK nuk ka përshkruar se cilat punë do të kryhen dhe për këtë pozicion ka vendosur përshkrimin "Punët e tjera" duke mos specifikuar llojin e punëve që do të kryhen gjatë renovimit të objektit të ish-IKSHP,që për ekspertin shqyrtues mos përcaktimi i sasisë në pozicionet 9,10 dhe 11 dhe mos përshkrimi i qartë i punëve që duhet të kryhen tek pozicioni 12 (Punët e tjera) paraqesin paqartësi për operatorët ekonomik për kalkulimin e ofertave të tyre.

Pozicionet 9,10,11 dhe 12 të vendosura nga AK në tabelën e paramasës dhe çmimeve

A.9 PUNËT PËR PËRMIRSIMIN E INSTALIMEVE ELEKTRIKE DHE NDRIQIMIT			
A.10 PUNËT PËR PËRMIRSIMIN E INSTALIMEVE TE UJIT DHE KANALIZIMIT DHE TE SANITARISE			
A.11 PUNËT PËR PËRMIRSIMIN E INSTALIMEVE TE NGROHJES DHE VENTILIMIT.			
A.12 PUNËT E TJERA			

OE ankues nuk ka ofruar fare çmime në pozicionet 9,10,11 dhe 12. Në njoftimin për kontratë apo tek tabela e paramasës së çmimeve nuk është ofruar ndonjë sqarim për pozicionet 9,10,11 dhe 12 nga ana e AK-së, gjithashtu as OE ankues nuk ka kërkuar sqarime për pozicionet e lartcekura.

Eksperti shqyrtues sqaron se OE me rastin e dorëzimit të tenderëve tek formulari i tenderit pajtohet me kushtet e dosjes se tenderit, pika 1.**"I kemi kontrolluar dhe pranuar plotësisht përmbajtjet e dosjes së tenderit. Në pranojmë dispozitat e saj në tërësi, pa rezervim ose kufizim.**

OE ka mundur para datës së dorëzimit të tenderëve të kërkoj sqarime nga ana e AK-se, apo edhe të paraqes kërkesë për rishqyrtim pranë AK apo edhe ankesë në OSHP në rast të refuzimit të kërkesës për rishqyrtim nga AK për ndonjë nga kushtet e njoftimit për kontrate dhe dosjes së tenderit konform nenit 108/A pika 1. Pretendimi ankimor është i pa bazuar

Përgjigje në Pretendimin 2

Lidhur me pretendimin tjetër të OE ankues, se AK ka rekomanduar për kontratë ofertën e OE "Bavaria" ShPK, edhe pse kjo ofertë nuk i përmbush kërkesat e njoftimit për kontratë sepse OE i rekomanduar për kontratë nuk ka ofruar listën e punëtorëve nga ATK për tri vitet e fundit siç është kërkuar në FDT, eksperti shqyrtues ka këtë mendim.

Në dosje të tenderit është kërkuar që OE duhet të dëshmon me Formularë të regjistruar në ATK- listën e punëtoreve së paku 30 punëtor e dëshmuar me Formularë të regjistruar në ATKk- listen e punëtorëve se paku 15 deri 20 punëtor.

OE i rekomanduar për kontratë ka dorëzuar listën e punëtorëve e vulosur nga ATK të datës 10.07.2020 e cila përfshin periudhën pesë mujore të vitit 2020 (janar –maj) dhe në këtë listë figurojnë 96 punëtorë.

Eksperti shqyrtues sqaron se lista e punëtorëve e dorëzuar nga OE i rekomanduar për kontratë e plotëson kërkesën e dosjes së tenderit dhe pretendimi i OE ankues se nuk ka dorëzuar listën e punëtorëve për tri vitet e fundit është i paqëndrueshëm sepse në kërkesën e FDT nuk është kërkuar lista e tri viteve të fundit dhe nuk është specifikuar se e cilës periudhe të vitit duhet ti takoj lista e punëtorëve, por vetëm është kërkuar lista e punëtorëve të ATK-së e cila duhet të ketë së paku 15 deri në 20 punëtor. Pretendimi ankimor është i pa bazuar.

Përgjigje në Pretendimin 3

Lidhur me pretendimin e OE ankues e OE i rekomanduar për kontratë nuk ka ofruar vendim për caktimin e menaxherit të projektit siç është kërkuar në FDT por vetëm ka ofruar një diplomë të një inxhinieri dhe sipas OE ankues dëshmitë e dorëzuara nuk e përmbushin kërkesën e FDT-së, eksperti shqyrtues ka këtë mendim.

Në dosje të tenderit është kërkuar që OE duhet të caktoj një Menaxher të projektit i cili duhet të jetë Ing.i ndërtimtarisë ose i arkitekturës dhe së paku ti ketë 2 vite përvoje pune pas diplomimit. OE i rekomanduar për kontratë ka dorëzuar një diplomë të z.Rrahim Latifi,baçellor i shkencave në ariktekturë i diplomuar në 2014 në Kolegjin UBT dhe një kontratë pune me z.Rrahim Latifi.

Eksperti shqyrtues sqaron se OE i rekomanduar për kontratë nuk ka dorëzuar dëshmi se z.Rrahim Latifi është caktuar si menaxher i projektit, gjithashtu bazuar në diplomën e ofruar,z.Rrahim Latifi është bachellor i shkencave në arkitekturë dhe nuk është ing.i arkitekturës siç është kërkuar në dosje të tenderit, andaj konsideroj që pretendimi ankimor i OE ankues është i bazuar. Pretendimi ankimor është i bazuar.

Përgjigje në Pretendimin 4

Sa i përket pretendimit tjetër të OE ankues se OE i rekomanduar për kontratë nuk e përmbush kërkesën e dosjes së tenderit për kontratat e realizuara sepse ka ofruar disa kontrata me operator privat dhe nuk ka ofruar dëshmi të realizimit të tyre siç është kërkuar në dosje të tenderit, eksperti shqyrtues ka këtë mendim.

Në dosje të tenderit është kërkuar që OE duhet të ofrojnë listën e kontratave për tri vitet e fundit, se paku tri referenca të kësaj lamije (ndërtim ose renovim). OE i rekomanduar për kontratë ka dorëzuar disa kontrata për punime/renovime sic janë kontrata me operatorin "Lin Projekt", kontrata me "Duhani Holding "Shpk, kontrata me "Euro Holdin H&C"Shpk dhe kontrata me "Prishtina city center". Për asnjërën nga këto kontrata OE i rekomanduar për kontratë nuk ka ofruar referencë për realizimin e punimeve, andaj konsideroj që

dokumentet e dorëzuara nuk e përmbushin kërkesën e dosjes së tenderit. Pretendimi ankimor është i bazuar.

Eksperti shqyrtues konstaton se AK nuk e ka bërë vlerësimin, ekzaminimin dhe krahasimin e tenderëve konform nenit 59 të LPP-së, dhe kërkesave të dosjes se tenderit,andaj rekomandoj që aktiviteti i prokurimit të anulohet sepse asnjëra nga ofertat e pranuara nuk është e përgjegjshme.
Autoritetet kontraktuese gjatë përgatitjes së dosjes së tenderit duhet të përcaktojnë specifika teknike të qarta dhe të matshme në mënyrë që OE të ofertojnë me oferta konkurruese që do të ishte në të mire edhe vet AK-së për shfrytëzim sa më racional të parasë publike.

Mendimi i ekspertit shqyrtues: Duke u bazuar në sqarimet e lartpërmendura, eksperti shqyrtues i propozon panelit shqyrtues që ankesa e OE ankues të aprovohet si e pjesërisht e bazuar, të anulohet njoftimi për dhënie të kontratës dhe rekomandon që aktiviteti i prokurimit të anulohet.

Autoriteti Kontraktues, me datë: 02.12.2020, me të parashtresës, ka njoftuar OSHP-në, se PAJTOHET me mendimin e ekspertit shqyrtues
Ju njoftojm se pajtohemi me mendimin e ekspertit per Anulim te procedures per lende: "Renovimi i objektit të ish –IKSHP-së për shërbime specialistike për Spitalin e Përgjithshëm Ferizaj" me nr. prokurimi 220-20-6824-5-2-1

Operatori Ekonomik, me datë: 03.12.2020, me anë të parashtresës, ka njoftuar OSHP-në, se NUK PAJTOHET me mendimin e ekspertit shqyrtues,

Seanca dëgjimore është mbajtur me datën: 09.12.2020, pa praninë e palëve konform nenit 24.1 të Rregullores së OSHP-së, e ku janë shqyrtuar shkresat e lëndës duke e bërë kontrollimin dhe analizimin e dokumentacionit për procedurën e prokurimit i cili përbëhet nga: autorizimi i inicimit të aktivitetit të prokurimit, njoftimi për kontratë, procesverbali mbi hapjen e ofertave, vendimi mbi themelimin e komisionit të vlerësimit të ofertave, raporti i vlerësimit të ofertave, njoftimi për dhënie të kontratës, ankesa e operatorit ekonomik, raporti i ekspertit shqyrtues të prokurimit dhe të gjithë parashtresat e palëve në procedurë.

Lidhur me pretendimin e grupit të OE Finaling"Shpk & NNP "Construction" & "NTSH'Edi floor", se AK gjatë vlerësimit, ekzaminimit dhe krahasimit të tenderëve ka eliminuar ofertën e tyre me arsyetimin se tek paramasa për tri pozicione (A 9, A 10, A 11) nuk ka ofruar çmime.
Paneli Shqyrtues konform ekspertit shqyrtues sqaron se AK në Letrën Standarde të datës 05.11.2020 ka përdorur Letrën Standarde për tenderuesin e pasuksesshëm duke nënvizuar që "Me keqardhje ju njoftojmë se

tenderi i paraqitur nga ana juaj është i **Pa suksesshëm** për arsye se te paramasa ju kane munguar tri pozicione (A 9, A 10, A 11) nuk ka çmim" duke përdorur në mënyrë të gabueshme letrën standarde, sepse nëse do ishte i pasuksesshëm OE ankues atëherë duhej të rekomandohej për kontratë ngase ka ofruar çmim më të lirë. Gjithsesi, Paneli Shqyrtues konform ekspertit shqyrtues konsideron që ky mund të jetë një gabim teknik i paqëllimshëm nga ana e AK. AK tek tabela e paramasës dhe çmimit ka vendosur 8 pozicione (të ndara në nën pozicione) ku janë përcaktuar edhe sasitë për çdo nën pozicion, ndërsa për pozicionet 9,10,11 dhe 12 AK ka dhënë një përshkrim të punëve që do të kryhen duke mos përcaktuar sasitë që nënkupton që OE për këto pozicione duhet të ofrojnë çmime paushallë Ne pozicionin 12 AK nuk ka përshkruar se cilat punë do të kryhen dhe për këtë pozicion ka vendosur përshkrimin "Punët e tjera" duke mos specifikuar llojin e punëve që do të kryhen gjatë renovimit të objektit të ish-IKSHP, që për Panelin Shqyrtues konform ekspertin shqyrtues mos përcaktimi i sasisë në pozicionet 9,10 dhe 11 dhe mos përshkrimi i qartë i punëve që duhet të kryhen tek pozicioni 12 (Punët e tjera) paraqesin paqartësi për operatorët ekonomik për kalkulimin e ofertave të tyre.

Pozicionet 9,10,11 dhe 12 të vendosura nga AK në tabelën e paramasës dhe çmimeve

A.9 PUNËT PËR PËRMIRSIMIN E INSTALIMEVE ELEKTRIKE DHE NDRIQIMIT			
A.10 PUNËT PËR PËRMIRSIMIN E INSTALIMEVE TE UJIT DHE KANALIZIMIT DHE TE SANITARISE			
A.11 PUNËT PËR PËRMIRSIMIN E INSTALIMEVE TE NGROHJES DHE VENTILIMIT.			
A.12 PUNËT E TJERA			

OE ankues nuk ka ofruar fare çmime në pozicionet 9,10,11 dhe 12. Në njoftimin për kontratë apo tek tabela e paramasës së çmimeve nuk është ofruar ndonjë sqarim për pozicionet 9,10,11 dhe 12 nga ana e AK-së, gjithashtu as OE ankues nuk ka kërkuar sqarime për pozicionet e lartcekura.

Paneli Shqyrtues konform ekspertit shqyrtues sqaron se OE me rastin e dorëzimit të tenderëve tek formulari i tenderit pajtohet me kushtet e dosjes se tenderit, pika 1."I kemi kontrolluar dhe pranuar plotësisht përmbajtjet e dosjes së tenderit. Në pranojmë dispozitat e saj në tërësi, pa rezervim ose kufizim. OE ka mundur para datës së dorëzimit të tenderëve të kërkoj sqarime nga ana e AK-se, apo edhe të paraqes kërkesë për rishqyrtim pranë AK apo edhe ankesë në OSHP në rast të refuzimit të kërkesës për rishqyrtim nga AK për ndonjë nga kushtet e njoftimit për kontrate dhe dosjes së tenderit konform nenit 108/A pika 1. Pretendimi ankimor është i pa bazuar

Lidhur me pretendimin tjetër të OE ankues, se AK ka rekomanduar për kontratë ofertën e OE "Bavaria" ShPK, edhe pse kjo ofertë nuk i përmbush kërkesat e njoftimit për kontratë sepse OE i rekomanduar për

kontratë nuk ka ofruar listën e punëtorëve nga ATK për tri vitet e fundit siç është kërkuar në FDT.
Paneli Shqyrtues konform ekspertit shqyrtues sqaron se në dosje të tenderit është kërkuar që OE duhet të dëshmon me Formularë të regjistruar në ATK- listën e punëtoreve së paku 30 punëtor e dëshmuar me Formularë të regjistruar në ATKk- listen e punëtorëve se paku 15 deri 20 punëtor.
OE i rekomanduar për kontratë ka dorëzuar listën e punëtorëve e vulosur nga ATK të datës 10.07.2020 e cila përfshin periudhën pesë mujore të vitit 2020 (janar –maj) dhe në këtë listë figurojnë 96 punëtorë. Paneli Shqyrtues konform ekspertit shqyrtues sqaron se lista e punëtorëve e dorëzuar nga OE i rekomanduar për kontratë e plotëson kërkesën e dosjes së tenderit dhe pretendimi i OE ankues se nuk ka dorëzuar listën e punëtorëve për tri vitet e fundit është i paqëndrueshëm sepse në kërkesën e FDT nuk është kërkuar lista e tri viteve të fundit dhe nuk është specifikuar se e cilës periudhe të vitit duhet ti takoj lista e punëtorëve, por vetëm është kërkuar lista e punëtorëve të ATK-së e cila duhet të ketë së paku 15 deri në 20 punëtor. Pretendimi ankimor është i pa bazuar.

Lidhur me pretendimin e OE ankues e OE i rekomanduar për kontratë nuk ka ofruar vendim për caktimin e menaxherit të projektit siç është kërkuar në FDT por vetëm ka ofruar një diplomë të një inxhinieri dhe sipas OE ankues dëshmitë e dorëzuara nuk e përmbushin kërkesën e FDT-së.
Paneli Shqyrtues konform ekspertit shqyrtues sqaron se në dosje të tenderit është kërkuar që OE duhet të caktoj një Menaxher të projektit i cili duhet të jetë Ing.i ndërtimtarisë ose i arkitekturës dhe së paku ti ketë 2 vite përvoje pune pas diplomimit. OE i rekomanduar për kontratë ka dorëzuar një diplomë të z.Rrahim Latifi,baçellor i shkencave në ariktekturë i diplomuar në 2014 në Kolegjin UBT dhe një kontratë pune me z.Rrahim Latifi. Paneli Shqyrtues konform ekspertit shqyrtues sqaron se OE i rekomanduar për kontratë nuk ka dorëzuar dëshmi se z.Rrahim Latifi është caktuar si menaxher i projektit, gjithashtu bazuar në diplomën e ofruar,z.Rrahim Latifi është bachellor i shkencave në arkitekturë dhe nuk është ing.i arkitekturës siç është kërkuar në dosje të tenderit Andaj, pretendimi ankimor i OE ankues është i bazuar.

Sa i përket pretendimit tjetër të OE ankues se OE i rekomanduar për kontratë nuk e përmbush kërkesën e dosjes së tenderit për kontratat e realizuara sepse ka ofruar disa kontrata me operator privat dhe nuk ka ofruar dëshmi të realizimit të tyre siç është kërkuar në dosje të tenderit.
Paneli Shqyrtues konform ekspertit shqyrtues sqaron se në dosje të tenderit është kërkuar që OE duhet të ofrojnë listën e kontratave për tri vitet e fundit, se paku tri referenca të kësaj lamije (ndërtim ose renovim). OE i rekomanduar për kontratë ka dorëzuar disa kontrata për punime/renovime sic janë kontrata me operatorin "Lin Projekt", kontrata me "Duhani Holding "Shpk, kontrata me "Euro Holdin H&C"Shpk dhe kontrata me "Prishtina city center". Për asnjërën nga këto kontrata OE i rekomanduar për kontratë nuk ka ofruar referencë për realizimin e punimeve, andaj konsideroj që dokumentet e dorëzuara nuk e përmbushin

kërkesën e dosjes së tenderit. Pretendimi ankimor është i bazuar.

Paneli Shqyrtues në bazë të shkresave të lëndës dhe sqarimeve të ekspertit shqyrtues, vjen në përfundim se AK nuk e ka bërë vlerësimin, ekzaminimin dhe krahasimin e tenderëve konform nenit 59 të LPP-së, dhe kërkesave të dosjes se tenderit. Andaj, ky aktivitet i prokurimit duhet të anulohet sepse asnjëra nga ofertat e pranuara nuk është e përgjegjshme. Autoritetet kontraktuese gjatë përgatitjes së dosjes së tenderit duhet të përcaktojnë specifika teknike të qarta dhe të matshme në mënyrë që OE të ofertojnë me oferta konkurruese që do të ishte në të mire edhe vet AK-së për shfrytëzim sa më racional të parasë publike. Pra, në mungesë të tenderëve të përgjegjshëm, Paneli Shqyrtues konsideron se ky aktiviteti i prokurimit duhet të anulohet në bazë të nenit 62 të LPP-së.

Paneli shqyrtues konform nenit 117 të LPP-së, si dhe duke u bazuar në provat e prezantuara si më lart vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

KËSHILLË JURIDIKE:

Kundër këtij vendimi nuk është e lejuar ankesa, por pala e pakënaqur me kërkesëpadi mund t'i drejtohet Gjykatës themelore-Departamentit për çështje Administrative në afat prej 30 ditësh nga data e pranimit të këtij vendimi.

Kryesuesi i Panelit Shqyrtues

Goran Milenković

Vendimi t'i dorëzohet:

1x1 AK "SPITALI FERIZAJ";

1x1 OE "FINALING"SHPK & NNP"EURO CONSTRUCTION"& NTSH"EDI FLOOR;

1x1 Arkivës së OSHP-së;

1x1 Për publikim në ueb- faqe të OSHP-së.